



EUROPEAN UNION

Ky projekt është
financuar nga
Bashkimi Europian



International
Labour
Organization

CEElex

Baza e të Dhënave të Legjislacioneve të Punës të Vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore



ZGJIDHJET E LEGJISLACIONIT TË PUNËS PËR BOTËN E PUNËS




Çfarë ofron CEElex?

CEElex është një bazë të dhënash ku mund të realizohen kërkime online dhe ku ofrohet informacion mbi legjislacionet kombëtare të punës në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore.

Bazuar në Konventat e ILO-s dhe në më shumë se 25 vite përvojë pune me legjislacionin e

punës në EQL, kjo bazë të dhënash ofron informacion të përzgjedhur esencial mbi punën dhe marrëdhëniet industriale në rajon. Temat që mbulojnë variojnë nga bisedimet kolektive tek kushtet e punës (p.sh. paga minimale, orët e punës), përfundimi i kontratave të punës, zgjidhja e mosmarrëveshjeve në punë, dhe format jo standarde të punësimit.



Cilat vende përfshihen në bazën e të dhënave të CEELex-it?

Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Hungaria, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Polonia, Rumania, Serbia, Sllovakia, Ukraina. Së shpejti do të përfshihen edhe Sllovenia dhe Lituania.

Për kë është krijuar CEELex?

- politikbërësit
- kërkuuesit
- përdoruesit e ligjit të punës
- gjyqtarët
- qeveritarët
- sindikalistët
- punëdhënësit
- studjuesit
- studentët e së drejtës.



Si funksionon CEELex?

Baza e të dhënave përfshin përmbledhje dhe citime nga paragrafë specifike të ligjeve dhe rregulloreve të punës në gjuhën angleze. Ju mund të kërkonit mbi legjislacionin sipas vendit dhe temës përkatëse, dhe mund të krahasoni vendet. Nëse doni të krahasoni kuadrin rregullator për Lirinë Sindikale në Shqipëri dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, CEELex-i ju mundëson gjetjen e informacioneve të hollësishme për të dy vendet.

Si u hartua informacioni për CEELex-in?

Kërkuuesit kombëtarë rishikuan legjislacionin primar dhe atë dytësor, marrëveshjet për bisedimet kolektive, si edhe të dhënat e disponueshme statistikore dhe administrative. Përfaqësuesit e Partneritetit trepalësh të ILO-s në këto vende (Qeveri, punëdhënës dhe punëmarrës) e kanë validuar informacionin. Platforma përditësohet një herë në vit.

Kontakt:

Cristina Mihes

Specialiste e Lartë Teknike për

Dialogun Social dhe Ligjin e Punës

budapest@ilo.org

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO)

Zyra Rajonale për Europën Qendrore dhe Lindore

www.ilo.org/budapest

**Shikoni dhe kërkonit në CEELex në adresën
ilo.org/ceelex**